

# DENOMINATION IN THE LEXIS OF POMOLOGY IN THE ALBANIANS DIALECTS

## EMËRTIMET E LEKSIKUT TË PEMËTARISË NË TË FOLMET SHQIPE

**Hana DARDHISHTA<sup>1</sup>**

<sup>1</sup>\* Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

\*Corresponding author e-mail: hana.rd@hotmail.com

### Abstract

This topic is about the lexis of pomology, because this lexicon is rich and gives a quite rich linguistic material. The language of a nation, though characterized by a standardized language of that nation, that language is diverse in its geographical position. As the main motive to discuss the vocabulary of pomology in the Albanian dialects was the diversity and richness that this vocabulary has, especially in the different dialects of the Albanian language. The interest was also for the influence and the relation of the Albanian language with the other languages and vice versa, especially with those languages with which it has been in contact the most, since some names have been influenced by it.

So, this paper treats the issue of names used in pomology, including its influence in the different dialects of the Albanian language. The richness and the variety of the lexis is a direct indicator of the richness and the development of the language. The spoken language of the people, which includes both the regional and the dialectal lexis, remains among the main ways of enriching the vocabulary of the Albanian language. Herein are included and shall be included words of specific meaning related to how people live and their habitat, such as with pomology.

**Keywords:** *language, pomology, denomination, phytonym, lexicon.*

### Përmbledhje

Kjo temë është e lidhur me leksikun e pemëtarisë, nga shkaku që ky leksik është i pasur dhe jep një material mjaft të begatë gjuhësor. Gjuha e një kombi, ndonëse karakterizohet nga një gjuhë letrare (standarde) e tij, megjithatë ajo gjuhë ka një laramani në pozitën e saj gjeografike. Si motiv kryesor për trajtimin e leksikut të pemëtarisë në të folmet shqipe, ishte larmia dhe begatia që ka ky leksik, sidomos në të folmet e ndryshme të gjuhës shqipe. Gjithashtu interesimi qëndronte edhe për ndikimin dhe marrëdhëniet e gjuhës shqipe me gjuhët e tjera dhe anasjelltas, sidomos me ato gjuhë me të cilat ka qenë më së shumti në kontakt, sepse edhe emërtimet e disa fjalëve janë me ndikim.

Pra, ky punim trajton çështjen e emërimit në pemëtarë, përfshirë këtu edhe tek të folmet e ndryshme të gjuhës shqipe. Pasuria dhe larmia e leksikut është tregues i drejtpërdrejtë i pasurisë dhe i zhvillimit të gjuhës. Ndër rrugët kryesore të pasurimit të fjalorit të gjuhës shqipe mbetet gjuha e folur e popullit, ku përfshihen kryesisht fjalori krahinor dhe dialektor. Këtu hyjnë e do të hyjnë fjalë me kuptim konkret, të lidhura me natyrën e me jetesën e popullit, ashtu edhe me pemëtarinë.

**Fjalët kyçe:** *gjuhë, pemëtarë, emërtim, fitonim, leksik.*

## 1. Emërtimi i frutave dhe llojet e fitonimeve

Hapësira gjeografike ku flitet gjuha shqipe është shumë e begatë me botë bimore, por natyrisht që gjuha shqipe me leksikun e saj të pasur nuk mund të kishte të gjitha emërtimet për pafundësinë e botës së gjallë, por ishte mjaftuar me ata emërtime për të cilat njerëzit kishin pasur nevojë. Kështu ekziston një lidhshmëri e drejtpërdrejtë në mes njeriut dhe natyrës në jetë e gjithësi edhe në kulturë.

Emërtimi i botanikës është ndërkombëtar dhe si gjuhë është zgjedhur latinishtja. Prandaj, kur përmendet emri botanik i bimëve, si dhe i pemëtarisë, shpesh përmendet «emri latin» i bimëve apo i pemëtarisë. Njerëzit këto emërtime i krijuan në mënyrë spontane në një kohë të caktuar dhe në një moment të caktuar gjatë jetës së tyre. Sa i përket ballafaqimit të gjuhës shqipe me gjuhën latine, në një lëmë të caktuar, këtë e pati bërë leksikografi i parë i gjuhës shqipe, Frang Bardhi, me „Fjalor latinisht-shqip” (1635, Romë).

Sa i përket çështjes së emërimit të këtij grupi fjalësh, ekzistojnë disa mendime, se nëse njeriu nuk do të kishte parë ndonjë përfitim nga bimët, ai edhe nuk do t'i kishte emërtuar ato. Kjo në njëfarë mënyre mund të vërtetohet edhe nga emërtimet e shumta për lloje të ndryshme të një fruti, si dhe e kundërta, drunjtë të cilët nuk kanë dhënë fruta apo nëse njeriu nuk ka pasur ndonjë dobi prej tyre qoftë edhe nga ato që janë të egra, nuk ka larmi të tillë leksikore. Si shembull mund të përmendim mollët, njerëzit i kanë dalluar, i kanë kultivuar dhe i kanë emëruar me më shumë emra, edhe pse të gjitha llojet i takojnë të njëjtit lloj të frutit.

Dallimet kanë qenë të natyrës së ndryshme: qoftë nga motivimi kohor, motivimi gjeografik apo edhe nga tiparet e brendshme apo të jashtme të vetë frutit. Por për vendet ku nuk kultivohet apo nuk rritet një frut i tillë, përdoret vetëm emri i përgjithshëm i frutit. Frutat tropikale, të cilat nuk kultivohen në vendin tonë deri vonë kanë qenë të panjohura për ne. Kështu frutat e tilla si avokado, mango, marakuja, noni, papaja etj., tek ne kanë ardhur së bashku me emërtimin e frutit në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Të gjitha këto fitonime që mund të hasen në të folmet shqipe mund t'i ndajmë në dy grupe:

- fitonime të trashëguara, dhe
- fitonime të huazuara.

Emërtimet e pemëtarisë janë të shumta, që do të thotë se përveç emërtimeve kryesore të pemëtarisë, në popull ekzistojnë shumë më shumë emërtime për këtë grup fjalësh. Në të folmet e ndryshme të gjuhës shqipe për emërtimin arrë hasim edhe variantet e ndryshme të këtij emërtimi, edhe atë si: çaçaniku, kaçka. Për emërtimin bajame hasim edhe variantet e ndryshme të këtij emërtimi, edhe atë si: amigdhale, bademi, mendulja, mendulla, midhalja, mindulla, minglla. Për emërtimin e caracit hasim edhe variantet e ndryshme të këtij emërtimi, edhe atë si: bobja, boboli, bobolja, çerçemi, çuçumi, fojleta, fuleta, goxhamishja, hidhëza, hini, hinëza, hithëthi, hithi, hiza, ithja, kaliboba, karabobja, karata, karateneja, kokobobja, kollopriftja, vidhëza, vidhi i butë.

Për emërtimin dardha hasim edhe variantet e ndryshme, edhe atë si: dardha e butë, dardha dimërore, dardhëza, dordhi. Për emërtimin gështenja hasim edhe variantet e ndryshme të këtij emërtimi, edhe atë si: gështenja e butë, kështenja, maroni. Për emërtimin hidja hasim edhe variantet e ndryshme të këtij emërtimi, edhe atë si: cinxifja, çimka, idja, këpeçi, kimça, kipça, mërçinja, shoshulla, xinxifja.

Për emërtimin hurma hasim edhe variantet e ndryshme të këtij emërtimi, edhe atë si: hurma e detit, hurma japoneze, hurma e madhe, kakia, llotë, molla japoneze. Për emërtimin kullumbria hasim edhe variantet e ndryshme të këtij emërtimi, edhe atë si: kulimri, kulmari, kulmria, kullumbria, kullumbridhja, kullumbrina, kumbulla e egër, kumria, morrizi. Për emërtimin kumbulla hasim edhe variantet e ndryshme të këtij emërtimi, edhe atë si: gërçinja, grumelja, kumbulla e butë,

kumbulla gërçinjë, kumbulla e gjatë, kumbulla gjatore, kumbulla gjinkallkë, kumbulla pestilkë, kumbulla e Vardarit. Për emërtimin lajthia hasim edhe variantet e ndryshme të këtij emërtimi, edhe atë si: fëndëku, lajthia e butë, lajthiza, lakthia, lejthia, lejthiza. Për emërtimin luleshtrydhe hasim edhe variantet e ndryshme të këtij emërtimi, edhe atë si: acarja, bishtshkurtra, bredhëza, çileku, dredhçnoja, dredhëza, dredhëza e bjeshkës, dredhëza e malit, dredhëza këmbëgjatë, dredhja e egër, gërtheni, gërthja, gugushaja, gugusharja, gulugutka, jupja, langshtrydhja, lëngshtrydhja, lugutka, luledredha, shtrydhësja, shtrydhëza, urtyta.

Për emërtimin mani hasim edhe variantet e ndryshme të këtij emërtimi, edhe atë si: mana toke, duda, kalldrini, mëni, murva etj. Për emërtimin manaferra hasim edhe variantet e ndryshme të këtij emërtimi, edhe atë si: dorëvata, ferra, ferra kulemanë, ferrëkulemana, ferrëmacja, ferrëmana, ferrëmana gjethevidh, ferrëmanëza, kapina, kërpanja, kupina, mana, mana bollicë, manëbollica, manëza, therra e zezë, therrëmana etj. Për emërtimin mjedhra hasim edhe variantet e ndryshme të këtij emërtimi, edhe atë si: dredhëza, gërgini, këmbëpulëza, malina, manaferra e butë, manaferra e kuqe, midra, mithra, mjedra, mjetra, njetra, ortiga, ndërsa për mjedhrën e egër si: mjedhra e egër zvarritëse.

Për emërtimin murrizi hasim edhe variantet e ndryshme të këtij emërtimi, edhe atë si: gllogu, kollogjina, morrizi, murrizi njëbërthamësh, rovna. Për emërtimin mushmolla hasim edhe variantet e ndryshme të këtij emërtimi, edhe atë si: mollëmuça, mushmolla dimërore, mushmolla e vjeshtës, mushmolla, mushmolla japoneze, muzulla, nespulla. Për emërtimin qershia hasim edhe variantet e ndryshme të këtij emërtimi, edhe atë si: bojlia, qershia e butë. Për emërtimin thana hasim edhe variantet e ndryshme të këtij emërtimi, edhe atë si: drënja, sharkuqja, sharrëkuqja, thana e butë, thana e kuqe, thanëkuqja, thanëza.

Për emërtimin vadha hasim edhe variantet e ndryshme të këtij emërtimi, edhe atë si: bula, surva, shurba, vadha e butë, vadhëza, vadhja, vallja, vodha, vodhëza, voesa, vojsa. Për emërtimin vishnja hasim edhe variantet e ndryshme të këtij emërtimi, edhe atë si: eshtnja, ishnja, marshka, vishnjaku.<sup>60</sup>

Përveç emërtimeve kryesore të pemëtarisë, duke pasur parasysh llojet e ndryshme dhe karakteristikat e ndryshme të një lloji të frutit dhe duke e ditur se ato kanë karakteristika të veçanta, emërtimet e këtyre nënlojeve të frutave i kemi ndarë si në vijim:

#### 1) Emërtime sipas motivimit gjeografik:

- tirankë (dardhë) sipas kryeqytetit të Shqipërisë, Tirana.
- amburku/hamburgu (rrush) sipas qytetit Hamburg të Gjermanisë.
- korithi/koridhi (rrush) sipas qytetit Korint, në Greqi.
- stambollkë (kumbull) sipas qytetit të Stambollit në Turqi.

#### 2) Emërtime sipas motivimit kohor:

- petrofkë (dardhë, kumbull) që piqet gjatë kohës së Shën Pjetrit, nga sllavishtja Петровден.<sup>61</sup>

#### 3) Emërtime sipas karakteristikave të jashtme apo edhe atyre të brendshme të frutit kemi:

- kantarkë, frut i cili sipas formës i ngjan topit të peshores për matje, kjo nga turqishtja khs. kantar.

-xhankë/xhanarinkë është emërtim që përfitohet duke krahasuar nga tur. can = shpirt + prapashitesa sllave –ka.<sup>62</sup>

<sup>60</sup> Për variantet e ndryshme të emrave të pemëtarisë shih: Lloshi, Xhevat, *Fjalor i emrave të bimëve dhe të kafshëve shqip-latinisht dhe latinisht-shqip*, Shkup, 2010.

<sup>61</sup> Poloska, Agim, *Leksiku dialektor në regjionin e Prespës*, Shkup, 2003.

<sup>62</sup> Skok, Petar, *Etimologijski rječnik hrvatskoga ili srpskoga jezika*, I, Zagreb, 1971-1974.

## 2. Emërtimet e pemëve si burim për toponimet

Një tipologji krejt e përgjithshme do të na jepte sisteme të ndryshme fitonimesh: gjuhësore, historike, etnografike etj. Një numër i konsiderueshëm i mikrotoponimeve të ndërtuara mbi bazën e fitonimeve, si: arrë, dardhë, dudë, fiq, kumbull, lajthi, murriz, rrush, thanë, vjosë etj., dëshmojnë të kaluarën historike të jetës rurale, të mënyrës së pranimi apo kuptimi të tyre, kuptohet në kohë të ndryshme si dhe simbolikën që merrnin etj. Emërtimet e drurëve kanë shërbyer në përgjithësi për emërtimin e vendeve.

Por, në këtë grup të madh edhe emërtimi i pemëve frutore është shumë i veçantë, p. sh.: në Pukë kemi: *Lajthiza, Dardha, Thanëza, Arraveci, Gorica, Kulumria*, pastaj *Manëz* - në Korçë, *Mollas* - në Elbasan, *Murriz* - në Lushnjë, *Qershizë* - në Korçë, *Shegan* - në Fier, *Gështenjas* - gjithashtu në Pogradec, *Ullinjas* - në Berat, *Hardhishtë, Dardhishtë, Vishnja* - në komunën e Strugës etj. Pastaj kemi edhe emra të drurëve frutorë në përbërje të mikrotoponimeve, si p. sh.: *Lugi Arrave, Lugi i Thanës, Kashtenjt e Begit, Fusha e Dredhëzave, Vreshti i Ganiut, Ullinjtë e Masatit, Shega me Gunga, Dardhas, Gjimolla etj.*

Emra bimësh kanë marrë territore të gjëra shqiptare si Dardania (toponimi Dardan-i, sikur mund të kuptohet është emër që rrjedh nga fisi ilir i dardanëve. Interesimi i Eqrem Çabejt për emrin e Dardanisë në studimet e tij ka qenë i veçantë dhe i shpeshtë. Emri i Dardanisë është bërë temë trajtimi dhe analize në fushë të leksikut (për emrin e dardhës), në fushë të toponimisë (emrin e Dardanisë dhe etnonimit dardan),<sup>63</sup> gjithashtu kemi edhe Qaf Thanë (nga thana) etj. Sipas Prof. L. Xhuvelit nga 3000 fshatra që ka Shqipëria 246 fshatra e kanë marrë emrin nga bimët, 41 nga bimët shkurrore dhe 16 nga bimë të ndryshme.<sup>64</sup>

Toponimet patronimet dhe antroponimet e shumta që vijnë nga lashtësia e deri në ditët e sotme, tregojnë se sa të rëndësishme kanë qenë këto lidhje. Mbiemra familjesh që përfaqësojnë bimë ose rrjedhin prej tyre janë të shumta e pothuajse përfshijnë të gjitha bimët drurore si: Dardha, Dardhishta, Fiku, Gorica, Mani, Murrizi, Thana, Thanasi, Thanati, Thano, etj. Po kështu dhe emra njerëzish si: Bajame, Bademe, Çerçem, Liman, Limone, Shega, Thanas, Tana, Ana, Tano, Tanush etj.

## 3. Ngjyrimi emocional (fitonimet dhe kuptimi figurativ)

Që fjalët me ngjyrim emocional kanë shprehësi të lartë është një gjë e njohur dhe e studiuar, mes së tjerash, edhe në leksikologji. Kështu, kur trajton përdorimet e figurshme të fjalës në gjuhën shqipe, J. Thomaj thotë shprehimisht : - Fjalët me ngjyrim emocional...i përdorim për t'i dhënë ligjëritimit më shumë forcë me qëllim që ta bëjmë më shumë bindës...".<sup>65</sup>

Gjithashtu do citoj fjalët e Xhevat Lloshit "Shprehja e figurshme origjinale është një eksperiment, në të cilin përfshihen sendet e dukuritë, frymorët e njerëzit me çfarëdo anë të tyre dhe marrin veti, trajta e ngjyra, lëvizje, tinguj, ndjenja, aftësi për të folur ... duke na dhënë një njohje e përjetim më të thellë se zakonisht".<sup>66</sup> Me emrat e bimëve populli ynë, gjithnjë lavdëron, e përgjithësisht mban qëndrim pozitiv, ndërsa me perimet ai shpreh qëndrim me konotacion pejorativ, keqësues.

<sup>63</sup> Eqrem Çabej, Emri i Dardanisë dhe izoglosat shqiptaro-kelte, botuar së pari në "Studime filologjike", ASH e RPSSH, IGJL, Tiranë, 1973, XXVII (X), nr. 3, f. 55-64; në Studime etimologjike në fushë të shqipes, A-O, "Rilindja", Prishtinë, 1977, f. 107; njësia leksikore "dardha" (formë e zgjeruar e njësisë leksikore, e shënuar më lartë) cit. nga Baliu, Begzat, Onomastikë dhe identitet, Prishtinë, 2012, f. 66-67.

<sup>64</sup> Xhuveli, Lufter, Bimët dhe shqiptarët, Tiranë, 2012, f. 287-288.

<sup>65</sup> J. Thomaj Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë 1999, f. 25.

<sup>66</sup> Xh. Lloshi "Stilistika dhe pragmatika", Tiranë, 2001, f. 137.

Dallojmë dy lloje ngjyrimesh emocionale: ngjyrim emocional pozitiv dhe ngjyrim emocional negativ. Në gjuhën shqipe mjetet e mënyrat për t'i dhënë fjalës ngjyrim emocional janë të ndryshme:

- Rruga e përdorimit të figurshëm të fjalëve;
- Përdorimi i prapashtesave me nuancë përkëdhelie ose keqësuese;
- Përdorimi i një intonacioni të veçantë.

Kuptimi gjuhësor emocional është edhe më i bukur, sidomos me përdorim të figurshëm të fjalëve. Për këtë bindemi nga shembujt e ndryshëm të vjelë nga këngët popullore, si në vijim:<sup>67</sup>

*Ti moj dardha rrumbullake, kush t'i puthi ato faqe, po ky djali pa mustaqe.*

*Mos je dardh'a mos je ftua? Ndë je ftua, je për mua., të të puth e të të dua, të të shtrydh posi limua.*

*O filiz i kumbllës, o filiz i holl', xhi t'dha Dashmir aga, xhi shtejne ndër dorë.*

*O moj moll' e bukurë, moll e pa këputurë...*

*Dy molla të kuqe, shkojshin nëpër male, bisedojshin njëra-tjetra, çobanin se marin.*

*Buzën që paske ti, të kuqe po si qersh, e bukur, e bukur më qenke ti!*

*Vetullën të hollë, synë rrush të zi, të keqen kunata ti qenke flori.*

*Hajde hajde, kalavesh me rrush, jena mirë çka s'asht kurkush.*

*Plasi toka bini molla, shegën lypa shegën mora.*

*Si do daesh tej dega e thonës-o, si ylli kour daet pi honës-o.*

*Syrin që paske ti, të zi por si ulli, lum ky djalë që po të merr ty.*

*Moj e vogëla xinxife mvish jelekun kadife.*

*Zerdela nëpër bashtë, mblihte ar e sërmë bashkë.*

Nëse bëjmë një analizë krahasimtare të leksemave që janë temë trajtim i punimit, dallojmë subjektin e krahasimit (gjëja që krahasohet), bazën, mjetin (lidhjen) dhe objektin (gjëja me të cilën bëhet krahasimi):

| Subjekti i krahasimit<br>(njeriu) | Baza<br>(ngjyrë)                 | Mjeti<br>(krahasues) | Objekti i krahasimit<br>(fruti) |
|-----------------------------------|----------------------------------|----------------------|---------------------------------|
| Fytyrë                            | Verdhë                           | si                   | limon                           |
| Fytyrë                            | Kuqe                             | si                   | mollë                           |
| Faqet                             | Kuqe                             | si                   | mollë                           |
| Fytyrë                            | Verdhë                           | si                   | ftua                            |
| Sy                                | kafe të errët në të<br>kuqërremë | si                   | gështenjë                       |
| Flokë                             | kafe të errët në të<br>kuqërremë | si                   | gështenjë                       |
| Sy                                | Zi                               | si                   | rrush                           |

<sup>67</sup> Shembujt e ndryshëm që janë dhënë më lartë, janë vjelë nga studimet e ndryshme dialektologjike, siç janë: Abedin Zenku, Këngë popullore lirike të Kërçovës, Shkup: Flaka e vëllazërimit, 1982; Beadin Sherifi, Lirika popullore prespane, Shkup: Logos-a, 1996; Edibe Selimi-Osmari, Lirika popullore në trevat e Tetovës dhe të Gostivarit. Tetovë, 2007; Jakup, Çitaku, Nga lirika popullore e Llapit, Prishtinë, 1974; Këngë popullore dasme, Instituti i folklorit, Tiranë, 1966; si dhe "Bleta shqiptare" e Thimi Mitkos, 1878.

|        |      |    |        |
|--------|------|----|--------|
| Buzët  | kuqe | si | qershi |
| Fytyrë | Kuq  | si | shegë  |

Shega pasqyrohet ose ka lidhje me shumë rite dhe me folklorin e trevave të ndryshme të vendit tonë. Dardha shpesh përfaqëson hijeshinë dhe në veçanti bukurinë femërore. Molla përbën një ndër simbolet që e ndeshim më dendur dhe si dru frutor, pemët e së cilës konsiderohen si simbole të jetës, lidhen me parimin femëror jetëdhënës. Duke i kënduar bukurisë femërore, gjithashtu shohim edhe krahasimet: sytë e zinj të vajzës me rrushin e zi ose me frutin e ullirit, faqet me mollën e kuqe ose me shegën, në disa raste edhe me qershinë, buzët gjithashtu me frutin e qershisë, p. sh.:

*syni i saj si kokrra e qershisë,  
fityra e saj si kuqet molla n'degë...(Martesa e Halilit)*

### 3. Përfundimi

Siç shohim nga shembujt e mësipërm, ngjyrat vërtetoheshin në një mënyrë të tërthortë, duke bërë krahasim me objektet dhe fenomenet e natyrës me të njëjtën ngjyrë. Fitonimet zënë një vend të veçantë, duke pasur parasysh që njerëzit të cilët jetuan shekuj me radhë nga bujqësia, është e kuptueshme që referencat e tyre të përditshme edhe për orientim, t'i kenë emërtuar me emrat e bimëve, luleve, prodhimeve bujqësore dhe sidomos pemëve, që në njëfarë mënyre paraqesin shenjat "e paluajtshme" orientuese në natyrë.

Hija e një druri apo peme gjithashtu ka shërbyer si orientim për matjen e kohës, që do të thotë, njerëzit në kohërat më të hershme orientoheshin me hijen e pemës, duke e matur kohën. Përveç emërtimeve të përgjithshme të pemëtarisë që i njeh gjuha shqipe, vijmë në përfundim se populli përdor shumë më shumë emërtime për të cilat ka pasur nevojë, duke i emërtuar sipas karakteristikave të ndryshme, njëkohësisht kështu edhe duke e begatuar më shumë gjuhën.

### Referencat

- [1]. Baliu, Begzat, *Onomastikë dhe identitet*, Prishtinë, 2012.
- [2]. Demiri, Mustafa, *Flora ekskursioniste e Shqipërisë*, Tiranë, 1981.
- [3]. Çitaku, Jakup, *Nga lirika popullore e Llapit*, Prishtinë, 1974.
- [4]. Fjalor i gjuhës shqipe (v. 1954), Ribotim nga "Botimet Çabej", Tiranë 2005.
- [5]. Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1980.
- [6]. Këngë popullore dasme, Instituti i folklorit, Tiranë, 1966.
- [7]. Lafi E., Caka N., Duro A., Rizaj M., punim studimor *Terminologjia profesionale si veprimtari ndërdisiplinore dhe detyrat e Alb-shkencës*, nr. 3-4, Shkup, 2014.
- [8]. Lyons, John, *Hyrje në gjuhësinë teorike*, Tiranë, 2001.
- [9]. Lloshi, Xhevat, *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë, 2001.
- [10]. Lloshi, Xhevat, *Fjalor i emrave të bimëve dhe të kafshëve shqip-latinisht dhe latinisht-shqip*, Shkup, 2010.
- [11]. Mitrushi, Ilia, *Drurët dhe shkurret e Shqipërisë*, Tiranë, 1955.
- [12]. *Pemëtaria I*, Shtëpia botuese e librit universitar, Tiranë, 2012.
- [13]. Poloska, Agim, *Leksiku dialektor në regjionin e Prespës*, Shkup, 2003.
- [14]. Sejdiu, Shefki, *Fjalorth etnobotanik i shqipes*, Prishtinë, 1984.
- [15]. Selimi-Osmeni, Edibe, *Lirika popullore në trevat e Tetovës dhe të Gostivarit*, Tetovë, 2007.
- [16]. Skok, Petar, *Etimologjiski rječnik hrvatskoga ili srpskoga jezika*, I, Zagreb, 1971-1974.
- [17]. Sherifi, Beadin, *Lirika popullore prespane*, Shkup, 1996.
- [18]. Thomaj, Jani, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006.
- [19]. Xhuvëli, Lufter, *Bimët dhe shqiptarët nga neoliti në shekullin 21*, Tiranë, 2012.
- [20]. Zenku, Abedin, *Këngë popullore lirike të Kërçovës*, Shkup, 1982.